

RAPORT NDËRKOMBËTAR PËR LIRINË E FESË SHQIPËRIA 2015

Përmbledhje e përgjithshme

Sipas kushtetutës, shteti është asnjans në çështjet e besimit, njeh barazinë dhe pavarësinë e grupeve fetare, ndalon diskriminimin fetar dhe garanton lirinë e ndërgjegjes dhe fesë. Qeveria ka patur marrëveshje me pesë grupe fetare që drejtonin marrëdhëniet e saj me këto grupe siç përcaktohet në kushtetutë. Qeveria u dha fonde katër prej këtyre grupeve. Grupet fetare raportuan përparim të dobët nga qeveria në më shumë se 1000 pretendimet e prapambetura për dëmshpërblim ose kthim të pronës së konfiskuar gjatë periudhës së komunizmit. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë shprehu zemërim në lidhje me shkatërrimin nga autoritetet lokale të një ndërtese për të cilën ajo tha se ishte kishë.

Nëpërmjet Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, drejtues të komuniteteve mysliman suni, ortodoks, katolik, protestant dhe bektashian u takuan për të diskutuar shqetësime të përbashkëta. Në janar kryetarët e komuniteteve katolik, mysliman suni, ortodoks dhe bektashian morën pjesë së bashku me kryeministrin në një marshim në Paris në nderim të viktimave të sulmit terrorist mbi *Charlie Hebdo*.

Zyrtarë të ambasadës amerikane vazhduan të nxitnin qeverinë të merrej me pretendimet për pronat fetare dhe t'u kthente grupeve fetare ndërtesat, tokën dhe prona të tjera të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit. Ambasada zgjeroi programin e saj për edukim qytetar, i cili theksonte pajtueshmërinë e vlerave qytetare me ato fetare. Zyrtarë të ambasadës folën me nxënës të shkollave të mesme publike si edhe të shkollave fetare islamike, katolike dhe ortodokse në lidhje me rëndësinë e tolerancës fetare. Ambasada gjithashtu punoi me komunitetin fetar për të shkurajuar ekstremizmin e dhunshëm, veçanërisht mes të rinjve. Kjo përpjekje përfshiu lehtësimin e diskutimeve mes palëve fetare, politike dhe atyre të zbatimit të ligjit.

Seksioni I. Demografia fetare

Qeveria e SHBA përlllogarit popullsinë totale në 3 milionë (përlllogaritje e korrikut 2015). Sipas një regjistrimi të përgjithshëm të popullsisë në vitin 2011, myslimanët suni përbëjnë afro 57 për qind të popullsisë, katolikët 10 për qind, anëtarë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë afërsisht 7 për qind dhe anëtarë të Urdhrit Bektashi (një trajtë e sufizmit shia) në 2 për qind. Grupet e tjera përfshijnë besime protestante, bahai, Dëshmitarë të Jehovait, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (mormonë) dhe një komunitet të vogël hebre. Afërsisht 20 për qind e personave refuzuan t'i përgjigjeshin pyetjes me zgjedhje për përkatësinë e tyre fetare.

Komiteti Shtetëror i Kulteve raporton afërsisht 230 organizata, fondacione dhe institucione arsimore fetare që veprojnë në vend.

Seksioni II. Gjendja e Respektimit të Lirisë së Fesë nga Qeveria

Kuadri ligjor

Kushtetuta përcakton se nuk ka fe zyrtare, të gjitha besimet janë të barabarta dhe se shteti ka detyrën të respektojë dhe mbrojë bashkëekzistencën fetare. Ajo përcakton se shteti është asnjans në çështjet e besimit dhe njeh pavarësinë e grupeve fetare. Sipas kushtetutës, marrëdhëniet mes shtetit dhe grupeve fetare rregullohen me marrëveshje ndërmjet këtyre grupeve dhe Këshillit të Ministrave, të miratuar nga kuvendi.

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe garanton lirinë e ndërgjegjes, fesë dhe shprehjes së lirë. Ajo deklaron se gjithkush është i lirë të zgjedhë ose ndryshojë fenë ose besimet e veta dhe t'i shprehë ato në mënyrë individuale, kolektive, në publik ose privatisht. Kushtetuta shpall gjithashtu se individët nuk mund të detyrohen të marrin pjesë ose të përjashtohen nga pjesëmarrja në komunitete ose praktika fetare, as të detyrohen të bëjnë publike besimet ose fetë e tyre apo të ndalohen t'i bëjnë këto nëse dëshirojnë. Ajo nuk lejon partitë politike ose grupe të tjera të nxisin urrejtje fetare.

Sipas ligjit, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr dhe përpunon ankesat për diskriminim, përfshirë ato që kanë të bëjnë me praktikat fetare. Ligji specifikon se Komiteti Shtetëror për Kultet, nën juridiksionin e Zyrës së Kryeministrit, rregullon marrëdhëniet mes qeverisë dhe grupeve fetare, mbron lirinë e fesë dhe nxit bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërfetar. Ligji gjithashtu e udhëzon këtë komitet të mbajë të dhëna dhe statistika mbi grupet e huaja fetare që kërkojnë ndihmë, dhe të mbështesë punonjësit e huaj të grupeve fetare në marrjen e lejeve të qëndrimit.

Qeveria nuk kërkon regjistrim apo licensim të grupeve fetare, por për të marrë statusin zyrtar një grup fetar duhet të regjistrohet në Gjykatën e Rrethit si shoqatë jofitimprurëse. Procesi i regjistrimit kërkon dorëzim informacioni mbi formën dhe shtrirjen e organizatës, objektivat e veprimtarisë së saj, identitetet e themeluesve të saj dhe përfaqësuesve ligjorë, si edhe strukturave të menaxhimit dhe mënyrës së tyre të veprimit, një adresë ku mund të kontaktohet organizata dhe pagesën e një tarife prej 1.000 lekë (8 dollarë) pranë gjykatës së rrethit. Caktohet në mënyrë të rastësishme një gjykatës brenda 3-4 ditësh nga dorëzimi i aplikimit dhe procesi zakonisht përfundohet brenda një seance. Regjistrimi u garanton grupeve fetare të drejtën të mbajnë llogari bankare, të zotërojnë prona dhe të marrin status përjashtimi nga taksat deri në një farë shkalle.

Qeveria ka marrëveshje me komunitetet e kishës katolike, myslimanët suni, ortodoksët dhe bektashianët si edhe me Vëllazërinë Ungjillorë të Shqipërisë (VUSH), një organizatë protestante ombrellë. Marrëveshjet dypalëshe shërbejnë për të kodifikuar marrëveshjet që kanë të bëjnë me njohjen zyrtare, rikthimin e pronës, mbështetje të drejtpërdrejtë financiare nga qeveria dhe/ose përjashtim nga taksat.

Ligji i kërkon Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave t'u japë përparësi pretendimeve nga grupet fetare për prona të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit.

Ligji lejon komunitetet fetare të ndërtojnë dhe menaxhojnë varreza fetare në tokat që ato zotërojnë.

Në tetor qeveria amendoi formalisht ligjin që lejon institucionet fetare të kenë kopshte fëmijësh.

Shkollat publike janë laike dhe ligji ndalon mësimet fetare në to. Shkollat private mund të ofrojnë mësimet fetare. Sipas shifrave zyrtare, grupet, organizatat dhe fondacionet fetare kanë 125 shoqata dhe fondacione anëtare që menaxhojnë 103 institucione arsimore. Sipas ligjit, këto shkolla duhet të licensohen nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe programi jofetar duhet të jetë në përputhje me standardet kombëtare të arsimit. Grupet katolike, myslimane dhe ortodokse kanë në veprim një numër kopshtesh, shkollash dhe universitetesh të licensuara nga shteti. Shumica prej tyre nuk kanë orë fetare të detyruara por i ofrojnë ato me zgjedhje. Komuniteti mysliman ka shtatë medrese që japin mësimet fetare përpos programit të përcaktuar nga shteti.

Praktikat qeveritare

Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi nuk pati ndonjë rast të ri diskriminimi mbi bazë feje por nxori vendimet për dy raste nga viti 2014. Në një vendim në nxjerrë në janar, komisioneri vendosi në favor të një vajze myslimane 16-vjeçare e cila tha se i ishte mohuar e drejta të ndiqte shkollën publike nga drejtori i shkollës pasi kishte filluar të vendoste shami në kokë. Megjithëse nuk kishte pengesë ligjore për veshje fetare në shkolla, drejtorët e shkollave gëzonin të drejtën të vendosnin standardet për “veshje të përshtatshme”, e cila në disa raste përfshinte kufizime në shfaqje publike të simboleve fetare. Komisioneri përcaktoi se ndalimi përbënte diskriminim dhe i kërkoi Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ta shfaqte atë. Ministria e apeloj vendimin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata mbështeti vendimin e komisionerit dhe nxënësja u kthye në shkollë në prill.

Në vendimin tjetër që përfshin një prokuror rrethi në Prokurinë e Rrethit Dibër, i cili pretendonte se prokurori i përgjithshëm në atë prokurori e kishte transferuar për shkak të besimit të tij fetar, komisioneri e mbylli çështjen pasi ankimesi vendosi të mos e vazhdonte ankesën e tij.

Grupet fetare raportuan se progresi ishte i ngadaltë në lidhje me pretendimet e tyre për kthimin dhe kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë periudhës komuniste. Për këtë, këto grupe fajësuan pjesërisht korrupsionin e qeverisë dhe ndërlikimet ligjore që i kanë rrënjët në të shkuarën komuniste të vendit - në veçanti pretendimet konkurruese mbi titujt. Nuk pati raportime që qeveria t'i ketë kthyer prona ndonjë komuniteti fetar, gjë të cilën komunitetet e parapëlqejnë në krahasim me kompensimin financiar. Qeveria ra dakord të kompensonte Komunitetin Mysliman të Shqipërisë (KMSH) për katër prona - një në Korçë dhe tre në Tiranë. Komunitetet fetare raportuan se që prej rënies së regjimit të mëparshëm komunist, kishin dorëzuar mbi 1000 pretendime në Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe pjesa më e madhe e tyre mbeteshin të pazgjidhura.

Në muajin gusht Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor shkatërroi një ndërtesë në Dhërmë, për të cilën banorët e zonës thanë se ishte kishë ortodokse. Sipas autoriteteve, kisha ishte ndërtuar pa leje në vendin ku ekzistonte më parë një kishë nga shekulli i 17-të dhe se ky vend kishte rëndësi trashëgimie kulturore për vendin. Ngjarja çoi në debat publik me qeverinë greke në lidhje me mënyrën se si u trajtua situata dhe disa politikanë shprehën publikisht kundërshtinë e tyre ndaj ndërhyrjes greke në atë që ata e konsideronin çështje të brendshme. Në këtë e disa raste të tjera, disa politikanë i thanë medias se ishin dyshues për atë që ata e perceptonin si ndikim grek mbi Kishën

Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe i mëshuan vënies në dukje se të krishterët ortodoksë të vendit ishin shqiptarë e jo grekë. Në tetor, me kërkesë të Partisë së minoritetit grek Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, kryeministri Edi Rama dëshmoi mbi shkatërrimin e ndërtesës në muajin gusht dhe mbrojti veprimet e autoriteteve. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë vazhdoi të protestonte mbi shkatërrimin.

Disa grupe fetare thanë se mosmarrëveshjet mbi zotërimin e titujve të pronësisë dhe problemet në verifikimin apo regjistrimin e pronësisë së tokës vështirësuan marrjen e hapësirave të reja për të ndërtuar objekte kulturi. Anëtarë të VUSH-it kanë marrë me qira ndërtesa ekzistuese por raportuan se vështirësitë në marrjen e tokës dhe ndërtimin e objekteve të tyre kanë penguar mundësitë e tyre për të kryer shërbime fetare. Vetëm 10 për qind e kishave të VUSH-it kishin në pronësi vendet e tyre të adhurimit, pjesa tjetër kishin me qira ndërtesa ekzistuese.

Në maj, gjatë vizitës së presidentit turk, KMSH-ja përuroi ndërtimin e një xhamie të re qendrore në Tiranë në tokë kthyer KMSH-së nëpërmjet procesit të kthimit të pronave. Ndërtimi i xhamisë u financua nga qeveria turke.

Në shtator komuniteti bektashian përuroi zyrat qendrore botërore në Tiranë që do të shërbejnë si vend qendror adhurimi, si qendër shumëfunktionale dhe si vatër e komunitetit global bektashian. Qeveria ndihmoi në financimin e ndërtimit. Bektashianët po ndërtonin dhe rikonstruonin gjithashtu disa vende kulturi në Korçë, Përmet, Gjirokastrë dhe Elbasan. Mosmarrëveshjet e pronës me qeverinë sollën vonesa.

Qeveria vazhdoi mbështetjen financiare për komunitetet katolike, myslimanëve suni, ortodokse dhe bektashiane, sipas përfaqësuesve të këtyre grupeve. Mbështetja financiare për këto katër grupe mbeti e njëjtë si në vitin e mëparshëm me 109 milion lekë (868.250 dollarë), e ndarë më katërsh mes tyre, ku komuniteti mysliman mori një pjesë pak më të madhe.

Qeveria nuk dha ende mbështetje financiare për VUSH-in pavarësisht marrëveshjes së tyre dypalëshe, pasi qeveria nuk e kishte amenduar ligjin origjinal që garantonte mbështetje financiare për këto grupe për të përfshirë VUSH-in ose të hartonte një ligj më vete. Përpos kësaj, VUSH-i deklaroi se kishat e tyre përballeshin me probleme në lidhje me kërkesa për pagesa taksash pavarësisht përjashtimit që parashikonte ligji. Sipas VUSH-it, qeveria ngriu llogaritë bankare të disa prej kishave të tyre për mospagesë. VUSH-i bëri disa kërkesa pranë Ministrisë së Financës dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për të diskutuar këto çështje por deri në dhjetor asnjë prej ministrive nuk u takua me ta.

Përfaqësuesit katolikë, ortodoksë dhe bektashianë vazhduan të pretendonin se numri i besimtarëve të tyre sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë të vitit 2011 paraqitet më i vogël se numri real dhe se paraqitja më e vogël e besimtarëve jep një pamje të pasaktë të demografisë fetare të vendit.

Seksioni III. Gjendja e respektimit të lirisë së fesë nga ana e shoqërisë

Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për Tiranën, Durrësin dhe gjithë Shqipërinë u përball me kritika drejtuar lidhjeve të supozuara me qeverinë greke.

Nëpërmjet Këshillit të Shqipërisë, drejtuesit e komuniteteve mysliman suni, ortodoks, katolik, protestant dhe bektashian diskutuan shqetësimet e përbashkëta. Drejtuesit fetarë shpesh ndoqën festimet e komuniteteve të feve të tjera. Në janar kryetarët e komuniteteve katolike, myslimane, ortodokse dhe bektashiane morën pjesë bashkë me kryeministrin Rama në një marshim në Paris në nder të viktimave të sulmit terrorist mbi *Charlie Hebdo*. Në shtator të gjitha komunitetet fetare morën pjesë në Takimet e përvitshme Ndërkombëtare të Lutjes dhe Paqes mbajtur në Tiranë dhe të sponsorizuara nga Komuniteti i *St. Egidio*, një grupim katolik.

Seksioni IV. Politikat e Qeverisë së SHBA

Zyrtarë të ambasadës amerikane u takuan me komisionerin shtetëror të kulteve dhe e kanë nxitur qeverinë të shqyrtojë pretendimet për prona fetare dhe t'u kthejë grupeve fetare ndërtesat, tokën dhe prona të tjera të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës shpesh përfshinë drejtuesit fetarë dhe anëtarët e komuniteteve, veçanërisht nga komunitetet myslimane suni, bektashian, katolik, ortodoks dhe protestant, në aktivitete si iftari ndërfetar i mbajtur nga ambasada ku ambasadori theksoi vlerën e tolerancës fetare. Zyrtarë amerikanë vizituan kisha, xhami dhe vende fetare gjatë gjithë vitit për t'u angazhuar me komunitetet gjatë festave fetare lokale.

Nëpërmjet një programi për edukimin qytetar, zyrtarë të ambasadës folën me nxënës të shkollave fetare myslimane, katolike dhe ortodokse, të shkollave të mesme publike dhe të institucioneve të tjera arsimore për të nxitur lirinë dhe tolerancën fetare. Si pjesë e programit, nxënës nga shkolla e mesme katolike dhe nga medreseja në Shkodër punuan së bashku për një prezantim që theksonte se si besimet e tyre fetare i kishin bërë qytetarë më tolerantë. Me fonde të ambasadës, nxënësit dhe mësuesit punuan me anëtarë të grupeve të tjera fetare dhe të shkollave në komunitet për të kryer projekte shërbimesh të përbashkëta dhe për të paraqitur kërkime mbi temat e vlerave të përbashkëta të besimeve fetare.

Ambasada amerikane punoi me komunitetet fetare, së bashku me aktorë shtetërorë dhe joqeveritarë, për të shqyrtuar ekstremizmin e dhunshëm mes të rinjve duke dhënë alternativa konstruktive. Këto aktivitete përfshinë seminare me figura kyçe të fesë, diskutime me drejtues të qeverisë, autoritete të zbatimit të ligjit dhe akademikë, si edhe projekte shërbimi që merreshin me çështje të mjedisit dhe varfërisë.